



MINISTRAT E SHËNDETËSISË  
DHE MBRQITJES SOCIALE  
Nr. 597 Prot.  
Datë 29.01.2018

REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

Dafimadher

VENDIM

Të ngrënien

Sfuanësh

Nr. 18, datë 12.1.2018

26/01

PËR

**SUBVENCIONIMIN E LIDHJES SË KONTRATAVE  
DHE TË VENDOSJES SË MATËSVE TË UJIT PËR KATEGORITË  
NË NEVOJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr.109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Subvencionimin e tarifës së lidhjes së kontratës dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë.
2. Kategoritë në nevojë, që përfitojnë nga subvencionimi i lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit janë, si më poshtë vijon:
  - a) Familjet të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar;
  - b) Familjet që kanë në përbërje anëtarë që përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, dhe që nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;
  - c) Familjet që kanë në përbërje anëtarë që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;

- ç) Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror ose që përfitojnë pension pleqërie fshati, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar.
3. Familjet e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, të cilat nuk disponojnë një kontratë të lidhur me ujësjellës-kanalizimet, sh.a., do të përfitojnë lidhjen e kontratës së ujit pa pagesë.
  4. Familjet e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, të cilat nuk janë të pajisura me matës të ujit në banesë, do të përfitojnë vendosjen e matësve pa pagesë.
  5. Listat e kategorive të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, ujësjellës-kanalizime, sh.a.-ja t'i marrë zyrtarisht brenda 7 (shtatë) ditëve të para të muajit nga bashkia e zonës së shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., në bazë të të cilave të bëhen lidhja e kontratës dhe vendosja e matësve, sipas pikave 3 e 4, të këtij vendimi.
  6. Listat e kategorive të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 2, të këtij vendimi, çdo bashki do t'i marrë zyrtarisht brenda 7 (shtatë) ditëve të para të muajit nga agjencitë e sigurimeve shoqërore dhe do t'i vendosë në dispozicion të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., në bazë të së cilave do të bëhet lidhja e kontratës dhe e vendosjes së matësve, sipas pikave 3 e 4, të këtij vendimi.
  7. Kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, deklarojnë pranë ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., se nuk disponojnë një kontratë të lidhur dhe/ose nuk janë të pajisur me matës në banesë dhe kërkojnë të pajisen me to. Ujësjellës-kanalizime, sh.a.-ja, kryen verifikimet përkatëse me listën që disponon të abonentëve ekzistues.
  8. Subvencionimi i ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., të mbulohet nga bashkia përkatëse, në përputhje me dokumentacionin që vërteton kontratën e lidhur dhe matësit e vendosur për kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.
  9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, programi “Furnizim me ujë dhe kanalizime”, zëri “Subvencione”.
  10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës, dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bashkitë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe ujësjellës-kanalizime, sh.a., për

zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2018.

KRYËMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
OGERTA MANASTIRLIU

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGIJE  
DAMIAN GJIKNURI